



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2009

SESIONI I

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme teknike profesionale (3+2) dhe 5-vjeçare

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë: një prozë dhe një poezi.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Skema tregon përgjigjet për secilën pyetje dhe për secilën pikë kur ajo vlerësohet me më shumë se 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve. Për rastet kur përgjigja e nxënësit nuk përshtatet plotësisht me përgjigjen në skemë, por afron me logjikën e pyetjes, komisioni i vlerësimit është i detyruar të këshillohet me drejtuesin teknik dhe me specialistët e AVA, për të bërë vlerësimin përfundimtar.
- Vlerësimi i pyetjes 13, është specifikuar me kujdes. Vlerësimi i saj do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh, ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

Pjesa I HEMINGUEJ**Plaku dhe deti****Pyetja 1 A 1 pikë****Pyetja 2 B 1 pikë****Pyetja 3 D 1 pikë****Pyetja 4 B 1 pikë****Pyetja 5 A 1 pikë****Pyetja 6 C 1 pikë****Pyetja 7 A 1 pikë****Pyetja 8 2 pikë**

a) epiteti 1: e bukur

b) epiteti 2: fisnike

- **2 pikë**, nëse nxënësi i zbulon të dy epitetet.
- **1 pikë**, nëse jep njërin nga epitetet.
- **0 pikë**, nëse nuk jep asnjërin ose gjen epitete dhe fjalë në tekst që nuk kanë lidhje me pyetjen.

Pyetja 9 2 pikë

* Nxënësi duhet të shkruajë dy fjali.

* Nxënësi duhet të shkruajë dy fjali, të cilat të kenë në përbërjen e tyre dy gjymtyrët kryesore (kryefjalë dhe kallëzues).

* Nxënësi duhet të shkruajë dy fjali, të cilat të japin thelbin e përmbajtjes për secilën pjesë.

Fjalitë e parë të japë idenë e raportit të plakut me zogun dhe fjalitë e dytë t'i referohet marrëdhënieve të plakut me peshkun.

- **2 pikë**, kur shkruan dy fjali, me dy kryegjymtyrë dhe me kuptimet përkatëse.
- **1 pikë**, kur shkruan njërin fjali me treguesit më lart.
- **0 pikë**, kur fjalitë nuk kanë treguesit e mësipërm, ose nuk i shkruan fare ato.

Pyetja 10 4 pikë**Arsyeja 1:** e vrau sepse ishte peshkatar dhe nga nevoja për ushqim..**Arsyeja 2:** e vrau nga kryelartësia.**Shembull 1:** këtë e bëra për të mos vdekur nga uria dhe për të ushqyer me të shumë njerëz.**Shembull 2:** ti e vrave nga kryelartësia dhe sepse je peshkatar.

- **4 pikë**, kur nxënësi jep dy nga përgjigjet më lart së bashku me shembujt.
- **3 pikë**, kur nxënësi jep tre nga treguesit e mësipërm.
- **2 pikë**, kur jep vetëm dy përgjigje.
- **1 pikë**, kur jep vetëm një përgjigje.
- **0 pikë**, kur i jep të gabuara ose asnjë përgjigje.

Pyetja 11 3 pikë.

a) **mënyra 1:** monologu me zë të lartë.

mënyra 2: monologu së brendshmi.

b) **funksioni:**

* të zbërthejë gjendjen psikologjike dhe shpirtërore të plakut.

* të shfaqë natyrën dhe gjendjen e plakut, të parashtrijë ide.

* ndërthurja e të dy llojeve sjell shtrirje dhe sintetizim të mendimit

- **3 pikë**, nëse nxënësi gjen të tre përgjigjet si më lart.
- **2 pikë**, nëse gjen dy nga elementët më sipër.
- **1 pikë**, nëse nxënësi jep njërin nga përgjigjet.
- **0 pikë**, nëse përgjigja nuk përshtatet me kërkesat ose nuk ka asnjë përgjigje.

Pyetja 12 3 pikë

a) **Gjuha** që i referohet zogut: -e thjeshtë, e brishtë, delikate, këshilluese, e gjallë, me rrjedhshmëri, sintaksë e rregullt pa stërhollime,

b) **Gjuha** që i referohet peshkut: - filozofike (përqendrohet te mëkati, thelbi), natyraliste (përpiqet ta interpretojë, por shkurt) etj

c) **Efekti:** Përfshirës, ndihmon në krijimin e marrëdhënieve të drejtpërdrejta, e bën lexuesin pjesëmarrës në ngjarje, e bën të thjeshtë dhe të kuptueshme fabulën.

- **3 pikë**, kur nxënësi përmend një tipar me të cilën plaku i flet zogut.
Një tipar me të cilën i flet peshkut dhe efektin e këtij komunikimi.
- **2 pikë**, kur jep dy tregues të tillë.
- **1 pikë**, kur jep vetëm njërin.
- **0 pikë**, për përgjigje që nuk kanë lidhje me gjuhën referuar zogut dhe peshkut si edhe efektin e kësaj gjuhe, ose kur nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 8 pikë**13a Shtjellimi i idesë 2 pikë . Duhet të kihen parasysh:**

- Fokusimi në temë, përshtatja me qëllimin e temës.
- Të flasë mbi një pasion të tijin, duke e thënë cili është ai.
- Të tregojë vlerat e tij.
- Të përshkruajë arsyet pse e pëlqen atë.
- Të tregojë nëse e ushtron atë, apo e ëndërron ta realizojë.
- Të thotë nëse ky pasion ka ndikuar ose mund të ndikojë në jetën e tij.

- **2 pikë**, kur ka treguesit e mësipërm.
- **1 pikë**, kur trajton temën përkatëse, por nuk jep argumente të qarta në lidhje me të
- **0 pikë**, kur nuk përshkruan asgjë, ose kur ajo që shkruan nuk ka kuptim.

13b Organizimi dhe struktura 2 pikë . Duhet të kihen parasysh:

- Pjesët përbërëse (hyrje, zhvillim, mbyllje).
 - Kronologjia (rend të mendimit dhe ideve, të shembujve që jep).
 - Logjika (të ketë lidhje me çfarë është thënë më parë).
 - Kalimet e kuptimshme (nga pasioni në efektet e tij), etj.
- **2 pikë**, kur nxënësi i plotëson standardet e mësipërme.
 - **1 pikë**, kur respekton vetëm strukturën formale, por nuk demonstron cilësi në ndërthurjen e saj me kuptimin.
 - **0 pikë**, kur struktura nuk të jep asnjë kuptim.

13c Stili dhe origjinaliteti 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:

- Shprehjet origjinale (figuracioni, fjalë jo të zhargonit të përditshëm).
 - Nëse stili është i gjallë, tërheqës, ndikues. (me rrjedhshmëri, të ketë efekt)
 - I qartë.
 - Jo imitues (të mbështetet te autori, por të japë dhe mendimin e tij).
- **2 pikë**, kur ka treguesit e mësipërm.
 - **1 pikë**, kur thotë diçka të vetën, por pa larmi, pa bukuri, pa shumë qartësi.
 - **0 pikë**, kur nuk thotë asgjë, ose nuk kuptohet asgjë nga ajo që ka thënë.

13d Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:

- Trajta e duhur e fjalëve.
 - Fjali të sakta.
 - Shenjat e pikësimit.
 - Shkronja e madhe.
- **2 pikë**, kur nxënësi ka bërë një përshkrim brenda normave të mësipërme
 - **1 pikë**, kur ka gabime, por kuptohet se çfarë ka shkruar.
 - **0 pikë**, kur gabimet e shumta deformojnë ose nuk lejojnë kuptimin e shprehjes.

Pjesa II Dritëro Agolli**Ëndrra e prerë**

- Pyetja 14 A 1 pikë**
- Pyetja 15 A 1 pikë**
- Pyetja 16 D 1 pikë**
- Pyetja 17 B 1 pikë**
- Pyetja 18 C 1 pikë**
- Pyetja 19 A 1 pikë**

Pyetja 20 1 pikë

Hardhia ose dega e hardhisë.

- **1 pikë**, kur e gjen detajin
- **0 pikë**, kur gjen një detaj tjetër, ose nuk shkruan asgjë

Pyetja 21 2 pikë

Shembujt janë: Pas shirave, arën e mbushi bari. Dalja e kërcellit të misrit (përdorimi i ndajfoljes ende), spërkatja e hardhisë që nënkupton lulëzimin e saj, ullishta është mbushur me mizë,

- **2 pikë**, kur jep dy nga shembujt e dhënë më lart.
- **1 pikë**, kur jep një shembull.
- **0 pikë**, kur nuk jep asnjërën ose i jep gabim.

Pyetja 22 3 pikë

Më poshtë jepen disa nga tiparet e stilit të Agollit. Nxënësi mund të referohet për të zgjedhur dy nga ato për t'i shpjeguar më pas si jepen në poezi.

- Tematika me motivet e jetës së përditshme si: trishtimet e vogla, zhgënjimi.
- Kulti i tokës, ëndrrës, vendit, ndjenjës etj.
- Poezi lirike, e lëvizjes, e ndryshimit, misionit.
- Figuracioni i pasur.
- Karakteri i drejtpërdrejtë, konkretizon ndjenjat, nuk ruan distancë nga ato. (i refrohet, tokës, ullirit, ëndrrës së njeriut etj).
- Veçoritë metrike, rima tingëlluese (metrikë e rregullt).
- Mbështetja në poezinë popullore (e bukura, dobia e natyrës, tingëllimi)

- **3 pikë**, kur jep dy nga tiparet dhe shpjegimin e tyre me referime në fragment.
- **2 pikë**, kur jep dy prej tyre pa shpjegim, ose një tipar bashkë me shpjegimin.
- **1 pikë**, kur jep njërin prej tyre.
- **0 pikë**, nëse nxënësi nuk jep asnjërën nga përgjigjet.

Pyetja 23 2 pikë

Nxënësi duhet të kapë që kuptimi i gjithë poezisë është dhënë që në titull.

2 pikë, nëse thotë po dhe shpjegon thjesht lidhjen e titullit me kuptimin e poezisë. Kuptimi i poezisë është pranë konstatimit që zhgënjimi i njeriut vjen prej mosrealizimit të ëndrrës ose idealit të vet. (pranohet interpretimi i mbështetur në zhgënjimin nga sistemi i diktaturës si poezi e pas viteve 1990).

- **2 pikë**, nëse thotë po dhe shpjegimin për një ëndërr të prerë në mes dhe trishtimit që ajo lë pas.
- **1 pikë**, nëse thotë vetëm po, pa shpjegim
- **0 pikë**, kur nuk përgjigjet fare, ose jep përgjigje tjetër.

Pyetja 24 3 pikë

- a) **vetë** : ndërthurje e vetës së dytë njëjës dhe të parë shumës. (pranohet edhe vetëm ndërthurja e vetës së dytë dhe të parë).
- b) **përemri vetor** : (ne, ti, tona).
- c) **folja**: (mos vdis, ëndërronim, të bënim, do ta ngrinim, ta ndërtonim, kishim ndërmend, t'i vinim, presim, të rrish, të vdesësh, t'i shihnim etj).
- **3 pikë**, nëse jep dy prej tyre, një folje , nje përemër dhe vetat e përdorura.
 - **2 pikë**, nëse jep dy prej tyre.
 - **1 pikë**, nëse jep njëjërën prej tyre.
 - **0 pikë**, nëse nuk jep asnjërin prej tyre ose jep përgjigje të gabuar.

Pyetja 25 4 pikë

- a) Ngjarjet e çojnë lexuesin në kohën e rinisë, në kohën e shkuar, në një kohë të largët, ku del ëndrra është dëshira idealiste për ndryshimet e mëdha në shoqëri.
- b) Aty kemi pranëvënien vajzë-sorkadhe. Autori i vë pranë për të dhënë kuptimin e së bukurës që ata adhuronin në rini, dhe të mënyrës sesi krijoheshin raportet në dashuri, konceptin e së bukurës dhe lidhjen e saj në dualitetin njeri-natyrë. Mund të shihet si ndikim i poetit nga krijimtaria popullore.
- c) Autori kujton vajzat dhe bukurinë e tyre. Sorkadhja e ka këtë veçori. Vajzat ishin të shkathta si sorkadhja, kërcenin si ajo, me shkathtësi dhe elegancë, të pakapshme.

Shënim: këtu mund të jepen variante të ndryshme përgjigjesh, e rëndësishme është të thuhet koha e rinisë, kujtesa për bukurinë e vajzave dhe ngjashmëria e kësaj bukurie me atë të sorkadhes.

- **4 pikë**, nëse nxënësi thotë: koha e rinisë, kujtesa për bukurinë e vajzave dhe ngjashmëria e kësaj bukurie me atë të sorkadhes.
- **3 pikë**, nëse thotë tre nga elementët më sipër.
- **2 pikë**, nëse thotë vetëm dy.
- **1 pikë**, nëse thotë vetëm njëjërën.
- **0 pikë**, për përgjigje të gabuar ose për mungesë përgjigjeje.